- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- 
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* )

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit /entit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj: Bashkelidhur dst

Specifikimi i Materialeve: bashkelidhur dst

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: bashkelidhur dst

**Shtojca 6***(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE****Afatet e realizimit të punimeve: bashklidhur dst**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Java 1/Muaji 1</b>	<b>Java 2/Muaji 2</b>	<b>Java 3/Muaji 3</b>	<b>Java 4/Muaji 4</b>	<b>Java 5/Muaji 5</b>
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

**Bashkelidhur dokumentave te tenderit.**

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas shtojcës 7.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatoret ekonomik duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të pakten një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që po prokurohet.

**2.2.2** Operatoret ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore për 3 vitet e fundit financiare të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**2.2.3** Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifën vjetore për vitin 2021 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit sipas QKB.(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifën vendore)

Kriteri sipas pikës 2.2.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore sipas parashikimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në zbatimin e punimeve të ndërtimit:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.***

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar,
  - Fatura tatimore,
  - Aktin e kolaudimit;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - **Shënim:** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Akt kolaudimi objekti;
  - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
  - Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:  
NP 2 - B; NP 3-B; NP 12 – A; NS 4-B; NS 18-A.

*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

- 2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik në licencë e shoqërisë me kontratë noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt të vertetuar me, diplomë, CV, Librezat e punës, dhe të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1(një)
- Inxhinier Mjedisi 1(një)
- Inxhinier Gjeodet 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3-muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

***Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

2.3.5 1(një) punonjes pjesë e stafit të shoqërisë të jetë i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.6 Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj.

2.3.7 Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjes e mjedisit”, i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj.



- 2.3.8 Njëri nga Drejtuesit teknik duhet të jetë i pajisur me certifikatë për Auditues energjie në ndërtesa, i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”.
- 2.3.9 Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj dhe kontrata e punës.
- 2.3.10 Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj.

***Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar *punonjës të kualifikuar* për realizimin e zërave të veçanta të punimeve si më poshtë:

- |                      |          |
|----------------------|----------|
| • Teknik ndërtimi    | 3(tre)   |
| • Teknik topograf    | 1(një)   |
| • Teknik Hidroteknik | 1(një)   |
| • Hidraulik          | 2(dy)    |
| • Mekanik            | 2(dy)    |
| • Manovrator         | 5 (pesë) |
- Për punonjesit e mësipërm të paraqiten kontratat e punes te vlefshme si dhe certifikata/diploma profesionale persecilin.Certifikatat/diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara, sipasligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh”
  - Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.
  - Ndërsa për teknikun e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet diploma e shkollës së mesme profesionale/licenca nga institucionet përkatëse.

*Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.*

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Teknik topograf-** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit , sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Teknik Hidroteknik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidroteknike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Hidraulik** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Manovrator** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës

2.3.12 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion: kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 5 (pese) shoferë. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,do të paraqiten perpara se AK të lidhe kontraten me operatorin ekonomik të shpallur fitues.**

2.3.13 Duke vlerësuar llojin , volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve të vendosur nga projektuesi për këtë objekt, çdo shoqëri pjesëmarrëse, duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi i një punësim mesatar minimumi prej 60 (gjashtëdhjete) punonjës për periudhën, të vertetuar me:

a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

b.Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se AK të lidhe kontratën me operatorin ekonomik të shpallur fitues.**

**2.3.14. Operatorët ekonomikë duhet të deshmojnë plotësimin e kriteve të vecanta teknike të mëposhtme:**

- Operatori ekonomikë kete Licençe per Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis (Auditim mjedisor ndikim ne mjedis) Kodi III.2.A (1+2).
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B

**2.3.16.** Pajisjet e domosdoshme për kryerjen e këtij investimi duke u nisur nga lloji dhe sasia e volumeve të punimeve dhe afati i punimeve si dhe kushtet në të cilat do të kryhet ky investim, mjetet e kerkuara janë si vijon:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Gjendja
1	Kamion me kapacitet mbajtes 10-12 ton	Copë	2	Pronësi ose me qera
2	Eskavator me goma	Copë	4	Pronësi ose me qera
3	Minieskavator me goma	Copë	1	Pronësi ose me qera
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 Ton deri ne 5 Ton	Copë	2	Pronësi ose me qera
5	Grejder	Copë	1	Pronësi ose me qera
6	Impiant prodhim Inertesh me QKL	Copë	1	Pronësi/qera/kontrate furnizimi
7	Impiant automatik betoni	Copë	1	Pronësi/qera/kontrate furnizimi
8	Fabrike Asfalti	Copë	1	Pronësi/qera/kontrate furnizimi
7	Fadrome me goma	Copë	3	Pronësi ose me qera
9	Asfalteshtruese	Copë	1	Pronësi ose me qera
10	Autobitumatrice	Copë	1	Pronësi ose me qera
11	Prerese Asfalti	Copë	1	Pronësi ose me qera
12	Badipald/Kompator	Copë	2	Pronësi ose me qera

13	Rrul ngjeshes mbi 18 Ton	Copë	2	Pronësi ose me qera
14	Rrul gome hekur 4-6 Ton	Copë	2	Pronësi ose me qera
15	Rrul gome-gome 5 Ton	Copë	1	Pronësi ose me qera
16	Aparat Testimi per presion tubash	Copë	1	Pronësi ose me qera
17	Aparat per ngjitje tubash PE	Copë	4	Pronësi ose me qera
18	Aparat saldimi me elektrofuzion	Copë	1	Pronësi ose me qera
19	Vibratore	Copë	2	Pronësi ose me qera
20	Betoniere	Copë	3	Pronësi ose me qera
21	Kulle Ndriçimi	Copë	1	Pronësi ose me qera
22	Nivelues Betoni	Copë	1	Pronësi ose me qera
22	Paisje gjeodezike tip total station me aksesor perkates	Copë	1	Pronësi ose me qera
23	Paisje gjeodezike tip nivelues me aksesore perkates	Copë	1	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, aktin e pronësise, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), certifikate per transport mallrash brenda vendit nese kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi ( e vlefshme) dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, aktin e pronësise, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , certifikate per transport mallrash brenda vendit nese kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi ( e vlefshme) të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Per Fabriken e Asfalto-Betonit dhe Linjen e Prodhimit te Materialeve Inerte duhet te paraqiten dokumentet e pronësise si akte çdoganimi ose fatura tatimore te blerjes, leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin, si dhe Planvendosje e vendodhjes se objektit e cila ne rastin e fabrikes se Asfalto-Betonit nuk duhet te jete ne distance me te madhe se 35 km nga objekti i prokurimit. Ne rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. *Distanca prej 35 km e Fabrikes se asfalto-betonit eshte vendosur ne perputhje me neni 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", VKM Nr. 628 date 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve" ne te cilin referuar trasportit te perzerjeve bituminoze te nxehta jepen rekomandimet e kerkesave minimale te cilesise per temperaturen e prodhimit/hedhjes ne veper dhe kohezgjatjes se transportit drejt saj, si dhe Ligji nr.8378, datë 22.7.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë Neni 140 "Kufizimet e shpejtesise". Gjithashtu operatoreve ekonomik ofertues te mundshem i eshte dhene mundesia te paraqesin dokumenta si akte pronesi apo me qera apo edhe kontrata furnizimi.*

- Per Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit duhet te paraqese planvendosjen dhe projektin teknologjik.
- d) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- e) Per secilin nga mjetet e kerkuara te paraqiten foto ku te jete e dukshme targat e mjeteve.
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr.7 . (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

### 2.3.17.

Shoqëria duhet të paraqesë: Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001** e vlefshme me auditim vjetor, certifikatën e menaxhimit mjedisor **ISO 14001** e vlefshme me auditim vjetor ose ekuivalente, certifikatën e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë **ISO 45001** (e vlefshme) ose ekuivalente, Certifikaten sistemet e tubacioneve plastike SSH EN SO 1452-1:2009 (e vlefshme me auditim vjetor). Ne rast bashkimi te OE duhet te plotesohet sipas perqindjes se marre persiper)

**Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

**Ne zbatim te nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.**

### 2.3.18 Operatori Ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- Cdo ofertues do te paraqese edhe **Grafikun i Punimeve** në përputhje me afatin e realizmit të punimeve te kerkuar.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës në tendër së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizë teknike për te gjithë zerat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007.

**Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkoje kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.**

*Keqinformimi dhe deklarimi i rreme me qellim kualifikimin e ofertes, ne menyre te padrejte, sanksionohet nga pika 1/a, te nenit 78 “Perjashtimi per nje periudhe te caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*

**Shtojca 8.***(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
 \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik  
(nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar


• **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

### **A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>	<b>Referencat (kur janë të zbatueshme)</b>
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni]

<p>data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjisllacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>



<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

## **B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po [ ]
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [ ] Jo [ ]
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).	Po [ ] Jo [ ]

<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p>

### C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

<p><b>Deklarata</b></p>
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
